



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	09 - 10 2023	3	vite god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHIK	6475/2023		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1114/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Sabile Avdyli, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1114/2023, të datës 25.08.2023, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ kundër Vendimit me numër protokoli 020-219/7, të datës 18.08.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1; nenin 16; paragrafi 3; dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.10.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1114/2023, e datës 25.08.2023, e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoli 020-219/7, i datës 18.08.2023, i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

### A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 25.08.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 020-219/7, të datës 18.08.2023, të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, më të cilin ankuesit i është refuzuar kërkesa për kompensim të funksionit shtesë. Pretendon së vendimi i kundërshtuar nuk është i drejtë dhe së i njëjti është nxjerrë në kundërshtim më vendimin e Këshillit. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe ankuesit ti njihet e drejta e kompensimit për funksion shtesë lidhur me punën në Kamisionin për Verifikimin e Respektimit të të Drejtave dhe Interesave të Qytetarëve në Komunën e Graçanicës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ( *tani e tutje Këshilli*), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa, kjo e fundit, më datë 08.09.2023, ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 5811/2023 të datës 25.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës: Vendimin me numër protokollit 020-219/7 të datës 18.08.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; Vendimin A.nr.852.2023 të datës 01.08.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës: E-mailin e datës 07.08.2023 nga ankuesi për ministrin dhe anëtarët e komisionit; E-mailin zyrtar të datës 09.06.2023 nga ankuesi për ministrin dhe anëtarët e komisionit; E-mailin e datës 25.04.2023 nga Menaxherja e Personelit për ankuesin; E-mailin e datës 08.06.2023 nga ankuesi për anëtarët e komisionit; E-mailin e datës 31.05.2023 nga ankuesi për anëtarët e komisionit; E-mailin e datës 10.05.2023 nga ankuesi për anëtarët e komisionit; E-mailin e datës 05.05.2023 nga ankuesi për anëtarët e komisionit; E-mailin e datës 25.04.2023 nga ankuesi për anëtarët e komisionit; E-mailin e datës 13.04.2023 nga ankuesi për anëtarët e komisionit; E-mailat e datës 07.08.2023, 09.06.2023, 25.04.2023, 08.06.2023, 31.05.2023, 12.05.2023, 10.05.2023, 05.05.2023, 25.04.2023, 13.04.2023, 03.04.2023 03.04.2023, 29.03.2023, 27.03.2023, 24.03.2023 nga faqe 11/16; Kërkesa për kompensim nga ankuesit e datës 13.04.2023 për Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; Vendimin me numër protokollit 020-219/5 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; Listën e nënshkrimeve e anëtarëve të Komisionit për të Drejtat e Qytetarëve në Komunën e Graçanicës mbajtur më datë 24.03.2023; Raportin lidhur me takimet e realizuara nga Komisioni për verifikimin e respektimit të të drejtave dhe interesave të qytetarëve në Komunën e Graçanicës të datës 24.03.2023 dhe 31.03.2023; kopja e ID-së dhe kopja e llogarisë bankare për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 23.03.2023 nga zyrtarja e MPB për propozimin e zyrtarit të lartë ligjor për komision; E-mailin e datës 23.03.2023 kërkesë për caktimin e komisionit nga MPB; E-mailin e datës 03.04.2023 -obligimet nga takimi i datës 24.03.2023; E-mailin e datës 24.03.2023 për emërimin e anëtarëve nga MMPHI; Kopja e letërnjoftimit dhe llogarisë bankare për \_\_\_\_\_ Kopja e letërnjoftimit për \_\_\_\_\_ Kopjen e llogarisë bankare për \_\_\_\_\_ Formularin e regjistrimit të ankesës e datës 25.08.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 04.09.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 1114/2023 i datës 07.09.2023 nga organi i punësimit; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 30.07.2013 për \_\_\_\_\_ Numri i protokollit dhe data kur është lëshuar vendimi nga KPMSHCK 5478/2023 datë 02.08.2023 dhe numri i protokollit dhe data kur MAPL ka pranuar vendimin e Këshillit 020-219/6 datë 04. 08.2023; Vendimin më numër protokollit 020-219/2, të datës 16.03.2023 i Ministrit të MAPL-së.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesi \_\_\_\_\_ është i punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, rrjedhimisht i njëjti sipas Ndryshimit dhe Plotësimit



të Aktit të Emërimit të datës 30.07.2013, ushtron pozitën e punës *Zyrtar për monitorim të komunave*, në Divizionin për Monitorim të Komunave.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së Ministri i MAPL-së, me Vendimin më numër protokolli 020-219/2, të datës 16.03.2023, ka themeluar Komisionin për Verifikimin e Respektimit të të Drejtave dhe Interesave të Qytetareve në Komunën e Graçanicës, ndërsa, me Vendimin me numër protokolli 020-129/5 të datës 23.03.2023 të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së, është bërë emërimi i përfaqësimit të anëtarëve të këtij komisioni në përbërje nga: përfaqësues nga MAPL të autorizuar \_\_\_\_\_ kryesues dhe \_\_\_\_\_ anëtar; përfaqësues nga MPB, i autorizuar \_\_\_\_\_ përfaqësues nga MMPHI, i autorizuar \_\_\_\_\_; dhe përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës të autorizuar \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_

Sipas sqarimeve në ankesë Komisioni për Verifikimin e Respektimit të të Drejtave dhe Interesave të Qytetareve në Komunën e Graçanicës, i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së me kërkesë për kompensim në emër të funksionit shtesë lidhur me punët në këtë komision dhe atë për muajin mars, prill, maj dhe qershor 2023, ku vetëm për muajin mars është aprovuar kërkesa për kompensim, mirëpo, që asnjëherë nuk kishte marr përgjigje lidhur me kërkesat e datës 05.04.2023, 10.05.2023 dhe 02.06.2023. Ankuesi, në emër të të gjithë anëtarëve të komisionit dhe i autorizuar si përfaqësues i përbashkët, me datë 15.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshilli, për shkak të mos kompensimit të pagës për funksione shtesë gjegjëshit lidhur me punën në Komisionin Ndërinstitucional për Verifikimin e Respektimit të të Drejtave dhe Interesave të Qytetareve të Komunës së Graçanicës.

Këshilli me Vendimin me numër A.nr.852/2023, të datës 01.08.2023, ka detyruar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, të shqyrtoj kërkesat e ankuesve të datës 05.04.2023, 10.05.2023 dhe 02.06.2023 si dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal me Vendimin me numër protokolli 020-219/7 të datës 18.08.2023, ka refuzuar kërkesën e ankuesit për kompensim të funksionit shtesë, me arsyetimin së nuk janë plotësuar kërkesat ligjore për kompensim.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji iu referuar dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë kompensimin për funksionin shtesë, përkatësisht Kolegji mori parasysh dispozitat e nenit 38, paragrafi 6, të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me të cilat është përcaktuar se: *“Kur zyrtaret/ët publik, sipas legjislacionit në fuqi emërohen/caktohen që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për zyrtaren/in, ky/kjo zyrtar/e publik/e ka të drejtën e kompensimit shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1. të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtarja/i publike, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. 3. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetaren/in dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët/ët, të pagës bazë së zyrtares/it kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 4. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 5. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 6. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe pas pëlqimit nga ministria*



*përgjegjëse për financa, me akt nënligjor miraton kriteret për përfitim të këtij kompensimi. Si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, me theks të veçantë dispozitat e nenit 5, 6, dhe 7 të kësaj rregullore ku përcaktohet se: Neni 5.1. Nëse një zyrtar publik i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, kërkohet që të shërbejë në ndonjë grup, ekip punues, autoritet apo organe të ngjashme ky zyrtar publik nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme e zyrtarit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur. 2. Përfshirja, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: .1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 2.3. funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë; 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar. Neni 6.1 Procedura për miratim të kompensimet Institucioni që themelon Bordin apo Komisionin sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje, në Vendimin e themelimit parashih të drejtën për kompensim të anëtarëve të Bordit apo Komisionit dhe e përcjell tek Njësia përkatëse për ekzekutim. Neni 7. 1. Vlera e kompensimit 1. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës bazë së zyrtarit kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 2. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 3. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje.”*

Rrjedhimisht, në kuptim të kuadrit ligjor, Kolegji ka analizuar vendimin me numër protokollit 020-219/7 të datës 18.08.2023, të Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së, për refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensim të funksionit shtesë gjegjeshit lidhur më angazhimin e ankuesit si kryesues i Komisionit për Verifikimin e Respektimit të të Drejtave dhe Interesave të Qytetareve në Komunën e Graçanicës, nga dhe konstatoi së vendimi i kundërshtuar më ankesë është nxjerrë mbi bazën e konstatimit të plotë të gjendjes faktike dhe më zbatim të drejtë të dispozitave materiale, pasi që, nga provat e lëndës rezulton së Komisioni për Verifikimin e Respektimit të të Drejtave dhe Interesave të Qytetareve në Komunën e Graçanicës, është themeluar brenda Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal pra në institucionin ku ankuesi është i punësuar, dhe se bazuar në shqyrtimin e Vendimit më numër protokollit 020-219/2 të datës 16.03.2023, Vendimit më numër protokollit 020-219/5 të datës 23.05.2023 si dhe Raporti të Punës së Komisionit të datës 09.06.2023, nuk vërtetohet fakti së Komisioni ka pas kompetenca të vendimmarrjes, andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave dhe konstatimeve rezulton së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, rrjedhimisht, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kërkesat ligjore për kompensim të funksionit shtesë siç është përcaktuar me nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132, paragrafi 2, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVË**

Lënda me numër A.nr.1114/2023

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

*Ardita Haxhnikaj-DEMI*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivit të KPMSHCK-së